



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË BIODIVERSITET (PLVB) TË KOMUNËS SË GJAKOVËS 2019-2024



Komuna e Gjakovës
Gjakovë, Tetor 2018



Profili për REC-un

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC – Regional Environmental Center) është organizatë ndërkombëtare neutrale, joavokuese dhe jofitimprurëse, e cila mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Kjo qendër e përmbush misionin duke promovuar bashkëpunim ndërmjet Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), qeverive, bizneseve si dhe personave tjerë kyç mjedisor si dhe duke përkrahur këmbimin e lirë të informatave dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen për mjedis. REC është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Aktualisht, REC bazohet ligjërisht në Kartën e vet, nënshkruar nga qeveritë e 29 vendeve dhe Komisioni Evropian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Hungarisë. Zyra qendrore e REC-ut është në Szentendre, Hungari si dhe zyrat fushore dhe zyrat e shteteve në 17 vendet përfituese.



© 2018 **Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet i Komunës së Gjakovës 2019 – 2024**

Akterët dhe përgjegjësit e PLVB/PLVM-së

Ky Projekt është implementuar nga:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC (Regional Environmental Center) - Zyra në Kosovë.

Qendresë Bytyqi

Koordinator i REC për PLVB/PLVM

Ekspertët e angazhuar nga REC

Prof. Asoc. Dr. Elez Krasniqi

Ekspert për biodiversitet (florë dhe vegjetacion)

Prof. Dr. Daut Rexhepaj

Ekspert për biodiversitet (faunë)

Prof. Dr. Kemajl Bislimi

Ekspert i mjedisit

Prof. Ass. Dr. Ferim Gashi

Ekspert për planifikimin hapësinor

Prof. Ass. Dr. Dukagjin Zeka

Ekspert i Bujqësisë dhe Agrobiodiversitetit

Atdhe Buzhala

Ekspert për Gjeodezi

Komuna e Gjakovës

Elida Bejtullahu – Projekt Menaxher

Fatos Deda- Koordinator i Komunës

Trupi Kordinues:

1. ***Arben Bakalli*** -Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,
2. ***Shkumbin Kastrati***-Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike,
3. ***Shpat Nivokazi***-Drejtor i Drejtorisë për Bujqesi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
4. ***Nikolle Lleshi***-Drejtor i Drejtorisë për Punë Inspektuse,
5. ***Ferdinad Kolaj***-Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik,
6. ***Adelina Shehu***-Kola-Drejtoresh e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
7. ***Durim Halilaj***-Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,



Grupi Punuës:

1. **Fatos Deda**-DUMM-Bashkëpuntor Profesional për Mjedis,
2. **Agron Zorra**-Zyrtar në Drejtorin për Bujqesi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
3. **Samir Sylmeta**-Zyrtar i Drejtoris së Shërbimeve Publike,
4. **Arber Gola**-Udheheq i Sektorit për Integritet Evropian,
5. **Nita Efendija**-Zyrtare për Informim
6. **Lumije Shllaku**-Përgjegjëse e Zyres për Barazi Gjinore,
7. **Bleta Kepuska**-Zyrtare në KRM "Çabrat",
8. **Jeton Kadiri**-Zyrtar në KRU "Gjakova",
9. **Gzim Marku**- Shoqata e gjahtarëve,
10. **Skender Sina**-Shoqata e Bjeshtetarve,
11. **Syria Shehu**-Shoqata Peshkatarve,
12. **Gasper Markaj**-Shoqata Pylltarve,
13. **Eanda Komnova**-Përfaqesues e Shoqëris Civile,
14. **Armend Behluli**-Përgjegjës i Zyres për Komunitete dhe Kthim,
15. **Arber Lleshi** - Përfaqesues i Shoqëris Civile.

Falënderim

Falënderojmë të gjithë qytetarët e komunës së Gjakovës, të cilët me bashkëpunimin e tyre kontribuan gjatë relizimit të hulumtimeve në terren.



PËRMBAJTJE

Fjala e kryetarit

Parathënie

1. HYRJE	9
2. PROCESI DHE METODOLOGJIA	13
3. QELLIMET E PROCESIT TË PËRGATITJES SË PLVB-SË.....	14
4. FAZAT E PLANIFIKIMIT TË PLVB-SË	15
5. PËRCAKTIMI I PROBLEMEVE, QËLLIMEVE DHE DETYRAVE.....	17
6. PLANI PËR ZBATIMIN DHE MBIKËQYRJEN E PLVB-SË.....	19
7. VIZIONI.....	21
8. ANALIZA E SITUATËS NË KOMUNËN E GJAKOVËS.....	22
9. ANALIZA E PROBLEMEVE PËR BIODIVERSITETIN E KOMUNËS SË GJAKOVËS.....	26
10. PROPOZIMI I MASAVE PËR MENAXHIM TË QËNDRUESHËM TË BIODIVERSITETIT.....	44
11. SHTOJCA.....	47
12. LITERATURA.....	48



Fjala e kryetarit

Për të menduar mbi ruajtjen e vlerave themelore mjedisore dhe bartjen e tyre gjeneratave në vijim pa dyshim se duhet të angazhohemi edhe për mbrojtjen e biodiversitetit. Probleme me biodiversitetin ka në tërë botën por edhe te ne në Kosovë. Këto probleme paraqesin shqetësim, prandaj kërkohet angazhim permanent në dobi të zgjidhjes së problemeve duke filluar nga individë deri te shoqëria si tërësi. Në të mirë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit në kontekstin e ruajtjes së diversitetit biologjik duhet të bëhen planifikime në momentin e duhur. Planit Lokal i Veprimit në Biodiversitet (PLVB) është një dokument strategjik në kuadër të një Planit Zhvillimor për një zhvillim të qëndrueshëm, i cili përveç vlerave duhet gjithashtu të njohë dhe të identifikoj edhe problemet.

Qëllimi i PLVB është të krijojë politika të përbashkëta të mbrojtjes së diversitetit biologjik në dobi të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të Komunës së Gjakovës.

Pasi që dihet rëndësia e mjedisit dhe e biodiversitetit për zhvillimin e qëndrueshëm, komuna e Gjakovës këtë vit ka vendosur që të financoj hartimin e Planit Lokal për Veprim në Biodiversitet dhe përditësimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis nga buxheti vetanak. Për këtë qëllim komuna e Gjakovës ka zhvilluar procedurat tenderike sipas ligjeve të Kosovës dhe ka kontraktuar Qendrën Rajonale për Mjedis – REC, zyra në Kosovë si organizatë me pervojë të gjatë në këtë fushë për implementimin e sukseshëm të këtij projekti me rëndësi vitale për mbrojtjen e Mjedisit dhe Biodiversitetit.

Shfrytëzoj rastin që në emër të Komunës së Gjakovës, në veçanti të falënderoj për bashkëpunim dhe mbështetjen e Agjencionin Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar - SIDA, e cila ka financuar hartimin e Planit paraprak në kuadër të mbështetjes së komunave të Kosovës ku përfituese ishte edhe komuna e jonë dhe Qendrën Rajonale për Mjedis - REC, e cila bëri implementimin e projektit në fjalë.

Me respekt,

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës




Parathënie

Bazuar në vlerat e biodiversitetit të cilat i ka territori i komunës së Gjakovës, atëherë Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet (PLVB) padyshim se është dokument me rëndësi. Njëherit kur këtyre vlerave u shtohen edhe vlerat kulturore-historike padyshim se begatohen vlerat e planit të përgjithshëm të zhvillimit të kësaj komune.

Komuna e Gjakovës, sipas shënimeve nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (2000), në vitin 1986 kishte sipërfaqe prej 58.735 ha, 46 ari e 39 m (Osmani, J. 2010). Territori i kësaj komune shtrihet në jug-perëndim të Republikës së Kosovës dhe paraqet të territorit të Kosovës i ndarë në 69. zona kadastrale. Kufizohet me Republikën e Shqipërisë, ndërsa në brendi të Kosovës kufizohet me komunat: Prizren, Rahovec, Klinë, Pejë dhe Deçan.

Në kuadër të territorit të KK të Gjakovës në kudër të diversitetit biologjik ka vlera të trashëgimisë natyrore të cilat janë të mbrojtura me ligj. Bazuar në të dhënave nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit - Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (AKMM - IKMN) rezulton se në territorin e KK të Gjakovës janë të evidentuara 3 Zona të Mbrojtura me Ligj (Çabрати, Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë dhe Shkukëza), respektivisht 28 zona të propozuara për marrje nën mbrojtje ligjore të propozuara në vitin 2003 (AKMM - IKMN 2008, 2010).

Bazuar nga sipërfaqja e tërësishme, relievi, karakteristikat klimatike, hidrologjike dhe vlerat e biodiversitetit si trashëgimi natyrore, duhet të mbrohen me ligj. Vlerat natyrore të veçanta mbrohen me ligj, me qëllim të ruajtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të natyrës, ndërsa kjo parashihet edhe me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/ L-233, në harmoni me Standardet e Bashkimit Evropian (BE), Unionin Botëror për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) etj.



Hartë e territorit të Komunës së Gjakovës (Punoi: Prof. Asoc.Dr. Ferim Gashi 2018)



1. HYRJE

1.1. Të dhëna për territorin e komunës së Gjakovës-vështrim i përgjithshëm

Territori i Komunës së Gjakovës sipas shënimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës të vitit 1986 kishte 69 zona kadastrale me sipërfaqe 58.735 ha, 46 ari, 39 m². Kjo komunë kufizohet me Republikën e Shqipërisë, me komunën e Prizrenit, Rahovecit, Klinës, Pejës dhe me komunën e Deçanit. Gjakova me rrethinë tani ka pozitë të mirë gjeografike, e gjithashtu pozitë të tillë kishte edhe gjatë të kaluarës historike dikur si vendbanim i vogël e tani qytet i shtrirë në pjesën jugperëndimore të fushëgropës tektonike të Rrafshit të Dukagjinit në kryqëzimin e rrugës dikur të rëndësishme transverzale Shkodër-Kosovë ose “Rruga e Zetës” (“Via di Zenta”) me atë longitudinale të rrafshit të Dukagjinit. Në kohën e sotme, Gjakova si komunë apo si qytet ka lidhje të mira komunikacioni me të gjitha komunat që e rrethojnë, si dhe me kryeqytetin e Kosovës (Prishtinën) dhe me pjesët tjera të Kosovës. Gjakova gjithashtu mund të lidhet edhe me hekurudhën (në Xërxë dhe Kramovik), ndërsa në pjesën veriore të saj gjendet edhe aeroporti i cili në perspektivë me siguri se do të ofroj komunën e Gjakovës me botën. Territori i komunës së Gjakovës përbëhet nga disa krahinëza të vogla si ajo e Dushkajës, Hasit, Rekës së keqe, Lugut të Çarragojit, Fushës së Gjakovës, etj. Ky territor si tërësi ka reliev të shumëllojshëm nga ultësirat e lumenjve deri te malet e larta, duke përbërë në vete tokë pjellore, fusha, male si dhe bjeshkë të larta (Osmani, J. 2010).

Gjakova me rrethinë ka klimë të mesme kontinentale të modifikuar me elemente të klimës mesdhetare. Ky ndikim i klimës mesdhetare vjen nëpërmjet Lumit Drini i Bardhë dhe përmes qafave të maleve (Çavolli, R. 1997, Vala, N. 1968 në Osmani, J. 2010, Pllana, R. 2015). Temperatura mesatare vjetore është 11.7 °C, ndërsa të sasia mesatare e reshjeve është mbi 1000 mm –Ponoshec (Pllana, R. 2015, Rexhepi, F. 1994, Kojic, M. & Pejcinovic, D. 1982, ASHAK 2018).

Komuna e Gjakovës ka lumenjtë: Ereniku, Krena, Lukaci, Drini i Bardhë dhe disa lumenj tjerë të vegjël por të rëndësishëm. Resurs me rëndësi hidrologjike është hidrosistemi “Radoniqi” i cili furnizon me ujë të puqshëm Gjakovën dhe Rahovecin si dhe ka kapacitet për ujitjen e 10.500 ha tokë (Osmani, J. 2010).



Në aspektin pedologjik dominojnë tokat e smonicave, tokat e zeza aluviale dhe tokat tjera të përshtatshme për drithra, pemë e hardhi, ndërsa në pjesët e larta ka kullosa dhe livadhe (Vala, N. 1968 në Osmani, J. 2010).

Në aspektin historik, ndër kulturat më të hershme në territorin e komunës së Gjakovës është ajo neolitike e Starçevës, e konstatuar në vendbanimin e vogël të Rogovës (lokalitetet “Kalldërma “ dhe “Selishtë”) (Osmani, J. 2010). Komuna e Gjakovës si tërësi territoriale sikur edhe Kosova si tërësi, e pushtuar kohë pas kohe deri në kohën tonë, në thellësi të tokës ruaj fakte arkeologjike të cilat ndoshta do të dalin në shesh në të ardhmen.

Sipas të dhënave lidhur me popullsinë, numri i banorëve të Gjakovës me rrethinë ka ndryshuar si në vijim: më 1844 kishte rreth 2000 shtëpi me mbi 21.000 banorë, më 1873/74 kishte 2060 shtëpi dhe 150 fshatra, më 1878/79 qyteti me rrethinë kishte 15.210 banorë, më 1891 kishte 52000 banorë, më 1913 rrethi i Gjakovës kishte 16 komuna me 59 fshatra, 3393 shtëpi dhe 32475 banorë, më 1921 rrethi i Gjakovës kishte 8 komuna me 101 vendbanime, 4805 shtëpi me 39214 banorë, më 1939 në rrethin e Gjakovës jetojnë 53737 banorë, me 1948 jetonin 56074 banorë, me 1961 jetonin 53270 banorë, me 1966 jetonin 59000 banorë, me 1971 komuna e Gjakovës kishte 71374 banorë, me 1981 kishte 92203 banorë, sipas regjistrimit serb të vitit 1991 komuna e Gjakovës kishte 120947 banorë, ndërsa pas mbarimit të luftës më 1999 komuna e Gjakovës kishte 15000 banorë, ndërsa në vitin 2000 (sipas të dhënave nga UNMIK) komuna e Gjakovës kishte 151800 banorë (Osmani, J. 2010).

Sipas shënimeve statistikore të vitit 2011 (bazuar në regjistrimin e e popullsisë 2011 dhe regjistrimi+shtimi natyror) komuna e Gjakovës kishte 95548 banorë (ASK 2013).

Zhvillimi i sotëm i vendbanimeve dhe diferencimi i tyre hierarkik nuk janë veçori të pandryshueshme por janë procese tejet dinamike që i nënshtrohen ndryshimeve të përhershme nën ndikimin e zhvillimeve shoqërore, ekonomike, politike, demografike dhe fizike. Në këtë kontekst ndarja territoriale e administrative ka rëndësi të veçantë duke mundësuar funksionimin dhe menaxhimin më të mirë të të gjitha tërësive hapësinore të vendbanimit, tërësi këto që janë në ndryshim të vazhdueshëm edhe në territorin e komunës së Gjakovës sikur edhe në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Kjo gjendje në vazhdimësi me dinamikën e saj ndikon edhe në vlerat e biodiversitetit, prandaj është e dobishme të vepohet me planifikime afatgjata me qëllim të parandalimit të degradimit të vlerave të tashëgimisë natyrore me theks të veçantë të vlerave të biodiversitetit.

Ky Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet (PLVB) është përgatitur në kuadër të projektit të



udhëhequr nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, Neni 140, paragrafi 2, si dhe është në harmoni me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodiverzitetin 2011 – 2020.

PLVB është në linjë me përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për forcimin e mëtejshëm të proceseve të planifikimit mjedisor në të gjitha nivelet. Duke marrë në konsideratë mungesën e sistemeve të kontrollit dhe ndërgjegjësimin e ulët të fushës së biznesit, insitucioneve dhe komunitetit për çështjet e mjedisit, projekti ka për synim përfshirjen e mjedisit-biodiversitetit në agjendën e përditshme të autoriteteve vendore dhe do të përcaktoj mënyrat dhe metodat e komunikimit me publikun, gjithnjë në dobi të pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes për çështjet mjedisore.

Duke analizuar rëndësinë e diversiteti biologjik të Kosovës, në rastin tonë konkret të territorit të komunës së Gjakovës, qëllimi kryesor i PLVB është që të mbështesë objektivat e Qeverisë së Kosovës, në përmbushjen e principeve të zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me standardet e BE. Kjo përfshin forcimin e kapaciteteve teknike dhe administrative të qeverisjes vendore dhe ngritjen e kapaciteteve, në proceset e hartimit të planeve mjedisore në nivel rajonal dhe vendor. Ky plan përcakton politikat për të gjithë sektorët e zhvillimit, duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve mjedisore, të përdorura për zhvillim, si dhe për mbrojtjen e vlerave të biodiversitetit.

Mbledhja e të dhënave nga disiplina të ndryshme nga territori i komunës së Gjakovës, duke filluar nga veçoritë fiziko-gjeografike, trualli, pasuritë natyrore dhe nëntokësore, uji, bujqësia, biodiversiteti, pyjet, të dhënat demografike, përdorimi i terreneve, energjia, mbetjet urbane, edukimi etj., pasi kaluan në disa stadi diskutimi, janë konceptuar dhe integruar me një fokus të qartë në mbrojtjen e natyrës me theks të veçantë në fokus të mbrojtjes së biodiversitetit.

Ky dokument pritet t’iu shërbejë autoriteteve qendrore dhe vendore, bizneseve, organizatave të ndryshme, specialistëve dhe grupeve të tjera të interesuara, për të zhvilluar më tej vizionet e tyre, për një zhvillim të qëndrueshëm me bazë përdorimi të resurseve-pasurive natyrore në mënyrë racionale në Komunën e Gjakovës.

1.2. Legjislacioni relevant për mbrojtjen e natyrës

Ligji nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (GZ-09.11.2010)

Ligji nr. 4/L-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Namuna" (GZ-21.01.2013)

Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (GZ-06.04.2009)

Ligji nr. 2003/14 për Planifikimin Hapësinor (GZ-01.10.2007)



Ligji nr. 03/L-106 për ndryshimin e Ligjit nr. 2003-14 për Planifikimin Hapësinor (GZ-25.11.2008)

Ligji nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (GZ-29.10.2010)

Ligji nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (GZ-29.10.2010)

Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina-Shtojca (GZ-29.06.2012)

Ligji për pyjet e Kosovës 2003/3 13.02.2003 me ndryshim plotësimet 2004/29 28.07.2004 dhe 03/L 15325.02.2010

Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës / Shtojca (GZ-29.04.2013)

Ligji nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja (GZ-29.03.2010)

Ligji për tokën bujqësore 02/L- 26 24. 06. 2005

Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (GZ-04.06.2008)

Ligji nr. 02/L-79 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike (GZ-01.06.2008)

Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma (GZ-15.10.2008)

Ligji nr. 02/L-116 për kimikate (GZ-15.08.2008)

Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtim-Shtojca (GZ-03.07.2012)



2. PROCESI DHE METODOLOGJIA

Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet (PLVB) për komunën e Gjakovës, është hartuar nga specialistë vendorë të udhëhequr respektivisht të kontraktuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), specialistë të komunës, përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe përfaqësues të Asamblesë komunale. Ky plan është konceptuar në kapitujt kryesorë: analiza e situatës, rekomandime dhe strategjia për zhvillim.

Ky PLVB, duke u kujdesur në mënyrë të veçantë në ndërveprimet ndërmjet çështjeve të ndryshme, për secilën çështje i paraqet problematikat, rekomandimet dhe ndërhyrjet konkrete.

Parimet kryesore të planit lokal të veprimit në biodiversitet janë:

- ✓ *Hartimi i platformës në mbrojtje të biodiversitetit*
- ✓ *Mbrojtja, ruajtja dhe konservimi i burimeve natyrore*
- ✓ *Miratimi i Zonave të Mbrojtura dhe shenjëzimi i kufijve të tyre*
- ✓ *Zonimi i vendndodhjes së bimëve endemike dhe kafshëve nën mbrojtje*

Me zhvillim i qëndrueshëm të biodiversitetit nënkuptohet ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të territorit që mbështet konkurrencën e tregut dhe përmbushjen e standardeve të kohës. Analizuar në përgjithësi, mbrojtja e mjedisit dhe nxitja e politikave të zhvillimit të zonave rurale e pyjore duhet të kombinohet me vënien në shërbim të njerëzve potencialet e tyre ekoturistike, produktet bio, dhe burimet e energjisë së ripërtërishme gjithnjë në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe biodiversitetit.

Ky dokument trajtohet në një rrjedhë logjike, ku së pari përcaktohen dhe analizohen problemet, dhe më pas jepen rrugët e mundshme për zgjidhjen e tyre.



3. QËLLIMET E PROCESIT TË PËRGATITJES SË PLVB-SË

Realizimi i këtij plani kërkon qasje efikase dhe aktive drejt zgjidhjes së problemeve në mjedis respektivisht në biodiversitet. Kjo nuk realizohet lehtë, pra është mjaft e vështirë edhe pse palët e interesit (publiku dhe institucionet) duhet të analizojnë me vetëdije problemet të cilat janë pothuajse të përditshme.

Analizuar nga kënvështrimi i ballafaqimit me biodiversitetin si fakt konkret, si vlerë etj. mund të shihet edhe arsyeja e komunës së Gjakovës për përgatitjen e planit për zgjidhjen e problemeve në biodiversitet, gjithnjë duke analizuar si të planifikohet zhvillim i qëndrueshëm afatgjatë i mjedisit respektivisht i komponentes së diversitetit biologjikë si vlerë reale për gjeneratat që vijnë pas neve.

Qëllimi i PLVB-së për komunën e Gjakovës është krijimi i një plani sa më të kompletuar e gjithëpërfshirës të aktiviteteve për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor në kuptim të qëndrueshmërisë së tij, gjithnjë bazuar në konsensusin në mes të vetëqeverisjes lokale-Komunës, qytetarëve, organizatave joqeveritare (OJQ) etj.

Ky plan është i bazuar në zgjidhje reale, të arsyeshme për mjedisin dhe ekonomikisht të pranueshëm, gjithnjë në dobi parandalimit të paraqitjes së problemeve respektivisht të zgjidhjes së problemeve ekzistuese të evidentuara në mjedisin jetësor. Realizimi i këtij plani para së gjithash ka si bazë analizën e gjendjes dhe përcaktimin e nevojave për zgjidhjen e problemeve në mjedisin jetësor respektivisht në biodiversitet me faktorin njeri në qendër të tij.

4. FAZAT E PLANIFIKIMIT TË PLVB-SË

Padyshim se realizimi i Planit Lokal për Veprimin në Biodiversitet (PLVB) si proces me rëndësi për nivelin lokal, ndikon edhe në nivelin qendror, njëherit kërkon angazhim serioz në trajtimin e problemeve të cilat paraqiten në hapësirë. Në këtë nivel është vepruar edhe gjatë realizimit të këtij PLVB.

Planifikimi është realizuar në disa faza, sikur në vijim:

- ✓ *Identifikimi i problemeve lidhur me gjendjen faktike në biodiversitet;*
- ✓ *Përcaktimi dhe mënyra e zgjidhjes së problemeve në terren;*
- ✓ *Përgatitja e planit dinamik;*
- ✓ *Përcaktimi i projekteve për tejkalimin e problemeve të konstatuara; dhe*
- ✓ *Analiza e situatës në komunën e Gjakovës (përparësitë, dobësitë, mundësitë, rreziqet)*



Takim pune në DUMM, Gjakovë (14.09.2018)



Ky PLVB është dokumenti gjithëpërfshirës, shumëdisiplinor dhe i ndërlikur i komunës së Gjakovës. Njëherit ky plan paraqet dinamikën e aktiviteteve për mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes faktike mjedisore në terren me theks të veçantë gjendjen e biodiversitetit. Në këtë rast mendohet posaqërisht në aspektet e zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore duke përfshirë biodiversitetin me karakteret e tija specifike (psh. llojet e rralla, llojet endemike etj.) në dobi të trajtimit profesional dhe të ruajtjes së tij.

Gjatë analizës së gjendjes dhe përcaktimit të problemeve, janë përfshirë komponentët kyç të mjedisit jetësor. Në këtë rast, PLVB ka për qëllim mbrojtjen e biodiversitetit në komunën e Gjakovës. Ky plan paraqet një bazë të mirë për ngritjen e politikave mjedisore të qëndrueshme, për krijimin e ekonomisë, e cila do të jetë gjithëpërfshirëse dhe do t'i përcaktojë dhe do të përfshijë cilësinë e ujërave, ajrit, tokës dhe biodiversitetit si dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në territorin e komunës së Gjakovës.

PLVB në komunën e Gjakovës krijon kushte për zhvillim të qëndrueshëm në biodiversitet poashtu edhe në dobi të tregëtimit me produkte farmaceutike - prej bimëve mjekësore dhe trajtim profesional të këtyre produkteve (mbledhja, përgatitja dhe konservimi) si dhe për shfrytëzimin e faunës. gjithashtu edhe hapja e shtigjeve për bashkëpunim ndërshtetëror, rajonal dhe më gjerë për zhvillim të ekoturizmit, është bazë për përmirësim të mirëqenies dhe standardit të jetesës të komuniteteve lokale.

Nëse kësaj situate të krijuar me planifikim të mirfilltë i shtohet edhe lehtësimi i politikave buxhetore dhe investimeve publiko-private, do të sigurohet qasje më e mirë në dobi të zhvillimit respektivisht shfrytëzimit të qëndrueshëm si dhe mbrojtjes së vlerave ekzistuese të biodiversitetit dhe zgjidhjen e problemeve mjedisore.



5. PËRCAKTIMI I PROBLEMEVE, QËLLIMEVE DHE DETYRAVE

Problemet e ndryshme të cilat paraqiten në PLVB, kërkojnë përgjigje respektivisht zgjidhje. Procesi i përgatitjes së PLVB-së është planifikim i cili fillon me caktimin e përparësive për çdo projekt, prandaj ato duhet të definohen.

Problemet, qëllimet dhe përgjigjet (reagimet)

Nr.	Problemi	Qëllimi	Përgjigje (reagimi)
1	Dëmtimi i pyjeve	Parandalimin e prerjeve ilegale	Bashkëpunimi me SHPK-ën, Gjykata dhe MBPZHR, zbatimi i Ligjit
2	Pyllëzimi	Rritja e sipërfaqeve me drurë-pyje	Bashkëpunimi me MBPZHR
3	Erozioni dhe demtimi i lumenjve	Marrja e masave për parandalimin e degradimit të shtretërve të lumenjve	Bashkëpunimi me MMPH
4	Ndotja e ujërave	Ngritja e vetëdijes dhe marrja e masave për mbrojtjen e ujërave nga ndotja	Bashkëpunimi me MMPH
5	Ndërgjegjësimi për vlerat e biodiversitetit	Ngritja e vetëdijes për vlerat e biodiversitetit në territorin e komunës së Gjakovës	Bashkëpunimi me MMPH- (AKMM- IKMN), Universitetet e Kosovës
6	Gjuetia e paligjshme	Ngritja e vetëdijes dhe marrja e masave për ndaljen e gjuetisë ilegale	Bashkëpunimi me MBPZHR dhe MMPH
7	Mbeturinat	Ngritja e vetëdijes dhe marrja e masave për	Bashkëpunimi me MMPH



		eliminimin e deponive ilegale	
8	Ndotja e ujërave si dhe ndotja e tokës nga mbeturinat inerte dhe komunale (amvisërisë)	Kontrollimi-monitorimi i ndotjes	Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të ndotura Zbatimi i Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit
9	Rrezikimi i florës dhe faunës së mbrojtur me ligj	Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e llojeve të mbrojtura me ligj	Bashkëpunimi me MMPH, Universitetet. Zbatimi i legjislacionit.



6. PLANI PËR ZBATIMIN DHE MBIKËQYRJEN E PLVB-SË

Për Planin Lokal të Veprimit në Biodiversitet të komunës së Gjakovës sikur edhe në çdo plan tjetër kërkohet planifikim, zbatim dhe mbikëqyrje. Planin për mbikëqyrje dhe vlerësim të PLVB-së përbëhet nga këto elemente:

- ✓ objektivat dhe qëllimet;
- ✓ detyrat;
- ✓ aktivitetet;
- ✓ institucioni dhe personi përgjegjës;
- ✓ kohën e zbatimit;
- ✓ buxhetin e parashikuar dhe burimet e tjera të financimit;
- ✓ rezultatet e pritura dhe treguesit e suksesit (indiktorët);
- ✓ burimet e informacioneve të cilët mund të verifikohen.

Planin për zbatimin dhe vlerësimin e PLVB të komunës së Gjakovës

Nr.	Qëllimet	Aktivitetet	Rezultatet e pritura	Treguesit e suksesit (indiktorë)	Burime të informacioneve	Personi përgjegjës	Burimet e nevojshme
1	Sipërfaqet e gjelbra në vendbanime	Realizimi i projektit sipas kohës së planifikuar	Kryerje e projektit, rregullimi-plotësimi i peizazhit	Ruajtja e biodiversitetit, ruajtja dhe mbrojtja e shëndetit të popullatës	Komuna	DSHP	Komuna Komuniteti Qeveria Donatorët
2	Pyllëzimet në vende të zhveshura-degraduara	Realizimi i projektit sipas kohës së planifikuar	Rritja e sipërfaqeve të gjelbra	Ripërtirja e biodiversitetit përmes revitalizimit të ekosistemeve të degraduara	Komuna	DSHP	Komuna Komuniteti Qeveria Donatorët



3	Pastrimi i shtretërve të lumenjve nga mbeturinat	Realizimi i projektit sipas kohës së planifikuar	Kontribut në rajtjen e gjendjes natyrore të shtretërve të lumenjve	Ruajtja e biodiversitetit	Komuna	DSHP	Komuna Komuniteti Qeveria Donatorët
4	Ruajtja e sipërfaqeve bujqesore	Realizimi i projektit sipas kohës së planifikuar	Kontribut në ruajtjen e agroekosis temeve tradicionale	Ruajtja e biodiversitetit përmes ruajtjes së agroekosistemeve	Komuna	DSHP	Komuna Komuniteti Qeveria Donatorët
5	Jo deponi ilegale	Realizimi i projektit sipas kohës së planifikuar	Kontribut në ruajtjen e biodiversitetit	Ruajtja e biodiversitetit	Komuna	DSHP	Komuna Komuniteti Qeveria Donatorët



7. VIZIONI

“Gjakova, rrëzë Pashtrikut dhe Bjeshkëve të Nemuna, vend tërheqës për ekoturizëm”

Komuna e Gjakovës ka pozitë të mirë gjeografike me resurse të shumta natyrore. Sipas këtyre fakteve, komuna e Gjakovës me plot të drejtë mund të bazohet në Planin Hapësinor për zhvillim të qëndrueshëm, ekonomik-social, infrastrukturë dhe teknologji moderne, me popullatë të arsimuar dhe profesioniste. Me plot të drejtë mund të konkludojmë se duke filluar nga qyteti i Gjakovës dhe më gjerë ka prezencë të vlerave të trashëgimisë kulturore, historike si dhe natyrore.

Vizioni i PLVB të komunës së Gjakovës, bazohet në zhvillimin e ekonomisë e cila mund të realizohet me përdorim të burimeve njerëzore, natyrore, kulturore-dhe atë jo vetëm për sot por duke menduar edhe për brezat e ardhshëm në kuptim të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky PLVB synon përmbushjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik-shoqëror në një treg konkurrues por edhe me standarde mjedisore, duke bashkërenditur politikat dhe veprimet e të gjithë sektorëve ndërveprues.



8. ANALIZA E SITUATËS NË KOMUNËN E GJAKOVËS

Analiza e situatës në territorin e komunës së Gjakovës shqyrton ndikimin e çështjeve të hulumtuara të cilat përmes përparësive dhe dobësive që veprojnë brenda mundësive e kërcënimeve-rreziqeve të cilat veprojnë nga jashtë, paraqesin faktorët kryesorë për zhvillimet e ardhshme në komunën e Gjakovës.

Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet

Përparësitë: 1. Popullata me moshë të re; 2. Gjakova si qendër rajonale; 3. Resurse natyrore të volitshme; 4. Rrjeti i mirë rrugor; 5. Toka pjellore dhe lumenjt; 6. Trashëgimia e pasur (kulturore historike dhe natyrore); 7. Parku Kombëtar dhe zonat tjera të mbrojtura me ligj; 8. Territori i komunës së Gjakovës me diversitet të pasur biologjik 9. Zejtari dhe tregti relativisht e zhvilluar; 10. Plani i përgjithshëm i zhvillimit dhe urbanistikës; 11. Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje;	Dobësitë: 1. Papunësia 2. Shfrytëzimi jo racional i burimeve natyrore; 3. Mungesa e statistikave të hollësishme; 4. Zënia e tokës pjellore për ndërtim; 5. Përdorimi joracional i tokave bujqësore; 6. Ndotja e lumenjëve, ajrit, ujërave; 7. Buxheti i pamjaftueshëm komunal; 8. Mungesa e donacioneve; 9. Përkrahje e pamjaftueshme e PLVB, për shkak të buxhetit të vogël.
--	--



Mundësitë: 1. Planifikim i dhe zhvillimi lokal përmes Planit të komunës për zhvillim, 2. Trashëgimi natyrore e kulturore; 3. Mjedis me vlerat të theksuara të biodiversitetit; 4. Resurse natyrore, bujqësi, lumenj e rrjedha tjera ujore 5. Bashkëpunimi ndërkufitar dhe rajonal; 6. Partneritet ndërmjet Pushtetit lokal + Shoqëria civile + Bizneset); 7. Burime njerëzore të edukuara 8. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i rezurseve të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” përmes hapjes së shtigjeve, shenjimi për alpinista, biciklista dhe bjeshkatarë.	Rreziqet: 1. Moszbatimi i ligjeve për mjedisin dhe biodiversitetin; 2. Ndotja e mjedisit, 3. Shfrytëzimi pa kritere dhe i pakontrolluar i resurseve natyrore; 4. Dëmtimi i shtretërve të lumenjve (pasojnë erozioni-vërshimet-përmytjet); 5. Vjelja pa kriter e bimëve mjekësore dhe aromatike; 6. Gjuetia e pakontrolluar e kafshëve të egra; 7. Peshkimi ilegal; 8. Prerjet e drurëve edhe në Zonat e Mbrojtura me ligj; 9. Zjarrvëniet.
--	---

8.1. Historiku i komunës së Gjakovës

Trashëgimia kulturore dhe materiale e territorit të komunës së gjakovës është e pasur (Krasniqi, M. 2017). Analizuar nga aspekti historik, ndër kulturat më të hershme në territorin e komunës së Gjakovës është ajo neolitike e Starçevës, e konstatuar në vendbanimin e vogël të Rogovës (lokalitetet “Kallërma “ dhe “Selishtë”) (Osmani, J. 2010). Territori i komunës së Gjakovës sikur edhe Kosova si tërësi, e pushtuar kohë pas kohe deri në kohën tonë që nga koha e pushtimit Romak në Iliri e deri më tani, në thellësi të tokës ruan fakte arkeologjike të cilat ndoshta do të dalin në shesh në të ardhmen.

8.2. Veçoritë fiziko-gjeografike të komunës së Gjakovës

Hapësira respektivisht territori i komunës së Gjakovës sipas shënimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës të vitit 1986 kishte 69 zona kadastrale me sipërfaqe 58.735 ha, 46 ari, 39 m². Territori i komunës së Gjakovës kufizohet me Republikën e Shqipërisë, ndërsa brenda në Kosovë kufizohet me komunën e Prizrenit, Rahovecit, Klinës, Pejës dhe me komunën e Deçanit. Gjakova me rrethinën e saj ka pozitë të mirë gjeografike, gjithashtu pozitë të tillë kishte edhe gjatë të kaluarës historike dikur si vendbanim i vogël e tani qytet i shtrirë në pjesën jugperëndimore të fushëgropës tektonike të Rrafshit të Dukagjinit në kryqëzimin e rrugës dikur të rëndësishme transverzale Shkodër-Kosovë ose “Rruga e Zetës” (“Via di Zenta”) me atë longitudinale të rrafshit të Dukagjinit. Tani, Gjakova si komunë apo si qytet ka lidhje të mira komunikacioni me të gjitha komunat përreth, si dhe ka lidhje me kryeqytetin e Kosovës



(Prishtinën) dhe me pjesët tjera të Kosovës. Gjakova gjithashtu lidhet edhe me hekurudhën (në Xërxë dhe Kramovik), ndërsa në pjesën veriore të saj gjendet edhe aeroporti i cili në të ardhmen me siguri se do të ofroj komunën e Gjakovës me botën. Territori i komunës së Gjakovës përbëhet nga disa krahinëza të vogla si ajo e *Dushkajës, Hasit, Rekës së keqe, Lugut të Çarragojit, Fushës së Gjakovës*, etj. Territori i lartëpërmendur si tërësi ka reliev të shumëllojshëm nga ultësirat e lumenjve deri te malet e larta, duke përbërë në vete tokë pjellore, fusha, male si dhe bjeshkë të larta (Osmani, J. 2010).

Gjakova me rrethinë ka klimë të mesme kontinentale të modifikuar me elemente të klimës mesdhetare. Ky ndikim i klimës mesdhetare vjen nëpërmjet Lumit Drini i Bardhë dhe përmes qafave të maleve (Çavolli, R. 1997, Vala, N. 1968 në Osmani, J. 2010, Pllana, R. 2015). Temperatura mesatare vjetore është 11.7 °C, ndërsa të sasia mesatare e reshjeve është mbi 1000 mm–Ponoshec (Pllana, R. 2015, Rexhepi, F. 1994, Kojic, M. & Pejcinovic, D. 1982).

Në territorin e komunës së Gjakovës kalojnë-rrjedhin lumenjtë: *Ereniku, Krena, Lukaci, Drini i Bardhë* dhe ca lumenj të vegjël por të rëndësishëm. Si resurs me rëndësi hidrologjike duhet përmendur hidrosistemi “*Radoniqi*” i cili furnizon me ujë të pijshëm Gjakovën dhe Rahovecin si dhe ka kapacitet për ujitjen e 10.500 ha tokë (Osmani, J. 2010).

Sa i përket aspektit pedologjik duhet theksuar se në territorin e komunës së Gjakovës dominojnë tokat e smonicave, tokat e zeza aluviale dhe tokat tjera të përshtatshme për kultivimin e drithrave, të pemëve e hardhisë, ndërsa në pjesët e larta ka kullosa dhe livadhe (Vala, N. 1968 në Osmani, J. 2010).

Kurse sa i përket botës bimore, pyjet në krahasim me territoret e komunave tjera janë më të varfëra. Pyjet shtrihen kryesisht në pjesët anësore të kësaj komune në Bjeshkët e Nemuna, të Dushkajës, të Hasit. Me katshmëri të rregullt vertikale shtrihen pyjet nga rrafshi deri në bjeshkët e larta. Edhe bota shtazore është deri diku e zhvilluar me kafshë të egra të cilat rriten edhe në treva tjera të afërta, sidomos në Bjeshkët e Nemuna (Osmani, J. 2010).

8.3. Zhvillimi shoqëroro-ekonomik i komunës së Gjakovës

Gjakova që nga themelimi i saj ishte treg i rëndësishëm i shkëmbimit të prodhimeve blegtorale malore të Malësisë dhe ato agrokulturore të Dukagjinit. Dihet se tragtarët e Gjakovës ishin të njohur në viset shqiptare, ata kanë vepruar me veprimtari të ndryshme zejtare, shërbyese e tregtare që para kohës së Perandorisë Osmane deri tani. Që nga lufta e parë botërore deri më 1989 kur konsiderohet se ka arritur maksimumin, Gjakova kishte ngritje sa i përket prodhimtarisë industriale në përgjithësi (Osmani, J. 2010).

8.4. Ndarja administrative-territoriale e komunës së Gjakovës

Gjakova gjatë të kaluarës historike, ka pësuar ndryshime në ndarjen administrative-territoriale që nga pushtimi romak i Dardanisë e deri me mbarimin e luftës së fundit me 1999 (Osmani, J. 2010).



8.5. Popullsia dhe vendbanimet në komunën e Gjakovës

Treva e Gjakovës përherë ishte e banuar me popullatë shqiptare, përkatësisht iliro-dardane, paraardhës të shqiptarëve. Sa i përket popullsisë, numri i banorëve të Gjakovës me rrethinë ka ndryshuar si në vijim: më 1844 kishte rreth 2000 shtëpi me mbi 21.000 banorë, më 1873/74 kishte 2060 shtëpi dhe 150 fshatra, më 1878/79 qyteti me rret kishte 15.210 banorë, më 1891 kishte 52000 banorë, më 1913 rrethi i Gjakovës kishte 16 komuna me 59 fshatra, 3393 shtëpi dhe 32475 banorë, më 1921 rrethi i Gjakovës kishte 8 komuna me 101 vendbanime, 4805 shtëpi me 39214 banorë, më 1939 në rrethin e Gjakovës jetojnë 53737 banorë, me 1948 jetonin 56074 banorë, me 1961 jetonin 53270 banorë, me 1966 jetonin 59000 banorë, me 1971 komuna e Gjakovës kishte 71374 banorë, me 1981 kishte 92203 banorë, sipas regjistrimit serb të vitit 1991 komuna e Gjakovës kishte 120947 banorë, ndërsa pas mbarimit të luftës më 1999 komuna e Gjakovës kishte 150000 banorë, ndërsa në vitin 2000 (sipas të dhënave nga UNMIK) komuna e Gjakovës kishte 151800 banorë (Osmani, J. 2010).

Bazuar në shënimet statistikore të vitit 2011 (regjistrimi i popullsisë 2011 dhe regjistrimi+shtimi natyror) komuna e Gjakovës kishte 95548 banorë (ASK 2013).

Vendbanimet në komunën e Gjakovës si dhe lokacioni i tyre është si rezultat i relievit dhe i elementeve tjera të bazës natyrore-gjeografike. Emrat e vendbanimeve, shpeshherë si dhe në vise tjera të Kosovës, mbajnë emra me bazë nga periudha të ndryshme historike si dhe me gjurmë të pashlyeshme nga periudha historike, Perandori e shtete të ndryshme sunduese nga periudha romake e deri në kohën tonë. Sot territorin e komunës së Gjakovës e përbëjnë këto vendbanime: *Arrnjeti (Rakovina), Babaj Bokës, Balldrini (Doblibare), Bardhani (Bardhaniqi), Bardosani, Botusha, Beci, Berjaha, Bishtaxhini (Bishtazhini), Blinishti (Lipoveci), Biteshi, Brekoci, Brovina, Cermjani, Dallashaj, Demjani, Deva, Dobroshi, Doli, Dujaka, Dushnja, Firaja, Firza, Fshaji, Gërçina, Gërgoci, Godeni, Guska, Gjakova, Hereçi, Hilaj (Osek Hilaj), Jahoci, Janoshi, Kastrioti (Novosella e Poshtme), Kodralia, Korenica, Kosharja, Kralani, Kusari, Kushaveci, Llugbunari, Llugaxhia, Madanaj, Marmulli, Meja, Meqa, Moglica, Molliqi, Morina, Neci, Nivokazi, Oriza, Pacaj, Palabardhi, Pashaj (Osek Pasha), Pjetërshani, Plançori, Ponosheci, Popoci, Qendresa (Smolica), Qerimi, Raça, Radoniçi, Rakoci, Ramoci, Rashkoci, Rogova, Rracaj, Rrezina, Rrypaj, Skiviani, Smaqi, Sopoti, Stublla, Sukasi (Dobrixha), Sheremetaj, Shëntereza (Novosella e Epërme), Shishmani, Shqiponja (Jabllanica), Trakaniqi, Ujzi, Vogova, Vraniqi, Zhabeli, Zhdrella, Zhubi dhe Zulfaj* (Osmani, J. 2010).



9. ANALIZA E PROBLEMEVE PËR BIODIVERSITETIN E KOMUNËS SË GJAKOVËS

Sikur edhe në hapësirën tjetër të Republikës së Kosovës, edhe komuna e Gjakovës ka problemet të cilat ndërlidhen me garantimin e një mjedisi të qëndrueshëm. Padyshim se për zgjidhjen e këtyre problemeve nevojitet angazhim i strukturave të pushtetit qendror e lokal, si dhe pjesëmarrja e komunitetit. Zgjidhjet reale për disa nga çështjet e rëndësishme mjedisore të cilat kanë të bëjnë me biodiversitetin, kërkojnë investime të konsiderueshme të cilat mund të tejkalojnë edhe mundësitë buxhetore të lokal por edhe të nivelit qendror. Në këtë situatë, realisht duhet analizuar mundësitë për zgjidhjen e problemeve të caktuara sipas prioriteteve gjithnjë në dobi të përmirësimit të gjendjes.

Padyshim se komuna e Gjakovës në territorin e saj posedon resurse të larmishme natyrore si mineralet jo metalore (ranore)-aloviale dhe deloviale, shkëmbinj gëlqeror, argjila, pastaj mineralet metalore si kromi, bakri, hekuri etj. (të cilat gjinden në viset malore). Gjithashtu territori i komunës së Gjakovës është i rrethuar me male-bjeshkë të pasura me pyje, kullota, fusha dhe tokë pjellore. Në pjesën lindore të territorit të komunës së Gjakovës kalon Lumi Drini i Bardhë i cili në vazhdimësi gjatë rrugës së tij rrjedhëse pasurohet edhe nga lumenjë tjerë, ndërsa me biodiversitetin e tij paraqet një gërshetim të resurseve natyror me rëndësi jo vetëm për komunën por edhe për Republikën e Kosovës.

Bazuar në resurset natyrore të cilat komuna e Gjakovës i posedon, ato duhet të mbrohen, të menaxhohen mirë duke reflektuar shfrytëzim të qëndrueshëm të tyre me ç'rast përfitojnë edhe vet banorët.

9.1. Biodiversiteti i Gjakovës

Edhe pse jo i hulumtuar në detaje, bazuar në të dhënat nga hulumtimet e deritanishme si dhe nga hulumtimi i realizuar në këtë rast, mendojmë se territori i komunës së Gjakovës ka biodiversitet mjaft të larmishëm dhe të pasur. Ky diversiteti i larmishëm i botës së gjallë është si rezultat i larmisë së ekosistemeve prezente në këto hapësira. Në shtrirje horizontale dhe vertikale, diversiteti është i larmishëm duke filluar që nga ultësirat deri te lartësitë më të mëdha në malet e larta të territorit të hulumtuar.

Llojet bimore dhe shtazore në territorin e komunës së Gjakovës janë të përhapura në ekosisteme të ndryshme, si në lumenjë e përgjatë tyre (Drini i Bardhë, Ereniku, Krena, Llukaci



dhe disa lumenj të vegjël por të rëndësishëm), në liqen (Liqeni i Radoniqit), në toka pjellore, livadhe e kullosa, male e bjeshkë të larta. Ky diversiteti biologjik zhvillohet si rezultat i kësaj larmie territoriale me gjeologji respektivisht me pedologji të ndryshme, duke filluar nga luginat-fushat aluviale rreth lumenjve, fushëgropa e Gjakovës, krahinat-hapësirat kodrinore si ajo e Hasit, Dushkajës etj., masivin malor në relacionin Qafë e Morinës-Qafë e Prushit, pjesët malore rrëzë Pashtrikut dhe deri te pjesët malore të Bjeshkëve të Namuna apo thënë më drejt të Alpeve Shqiptare-pjesa e Kosovës.

Për shkak të vlerave të trashëgimisë natyrore rreth 5% (afro 3000 ha) të Parkut Nacional “Bjeshkët e Namuna” shtrihen në territorin e komunës së Gjakovës. Poashtu në kuadër të territorit të KK të Gjakovës në kuadër të diversitetit biologjik ka vlera të trashëgimisë natyrore të cilat janë të mbrojtura me ligj por edhe të propozuara për mbrojtje me ligj (AKMM - IKMN 2008, 2010). Nga numri i gjithmbarshëm prej 3 Zona të Mbrojtura me Ligj (“Çabрати “Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë” dhe “Shkukëza”), respektivisht 28 zona të propozuara për marrje nën mbrojtje ligjore të propozuara në vitin 2003; në mënyrë direkte apo indirekte është fjala edhe për vlera të biodiversitetit. Në kuadër PLVB në komunën e Gjakovës janë realizuar dhjetë ekspedita hulumtuese në terren (EK & DR / 07-17.09.2018) të cilat nxorën në shesh rezultate relevante të cilat do të paraqiten në këtë rast.



Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë (EK-10.09.2018)



9.1.1. Flora dhe vegjetacioni në komunën e Gjakovës

Në kuadër të shumëllojshmërisë së botës së gjallë-biodiversitetit, vend me rëndësi padyshim se ka edhe mbulesa bimore apo thënë ndryshe flora dhe vegjetacioni.

Sikur edhe në hapësira tjera në kuadër të territorit të Republikës së Kosovës, bazuar në pozitën specifike gjeografike, duke konsideruar rolin e faktorëve orografikë, gjeologjikë, pedologjikë, klimatikë; territori i komunës së Gjakovës është vend i përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e llojeve (specieve) dhe bashkësive (fitocenoza) të ndryshme bimore.

Sipas ndryshimeve bazuar në lartësinë mbidetare, në shtrirje vertikale të florës dhe vegjetacionit të territorit të komunës së Gjakovës dallojmë disa zona. Këto zona janë të ndryshme varësisht nga pozita gjeografike, përbërja gjeologjike, relievi, madhësia e masivit të caktuar etj.

Flora dhe vegjetacioni i zonave të ulëta mbidetare

Territori i komunës së Gjakovës ka hapësirë të konsiderueshme e cila i takon zonave me lartësi të ulët mbidetare. Këto hapësira janë të shtrira përgjatë rrjedhave të lumenjve Drini i Bardhë, Ereniku (me të cilin bashkohen Lumbardhi i Deçanit, Trava, Llukavci dhe së bashku afër Bishtazhin derdhen në Lumin Drini i Bardhë).

Këto hapësira gjinden përgjatë rrjedhës së Lumit Drini i Bardhë, në relacionin: Kralan-Rakovinë-Meqë-Doblibare-Berdosanë-Marmull-Bishtazhin-Rogovë. Pastaj, hapësira tjera gjinden përgjatë rrjedhave të lumenjve dhe përrojeve e rrjedhave tjera ujore në relacionet: Zhdredhë – Bec – Vraniq - Doblibarë; Bitesh – Lugbunar - Qerim; Hereç – Plançor – Skivjan - Osek; Dobrosh – Nec – Smolicë - Duzhnje; Batushë – Mulliq – Brovinë – Ponoshec – Popoc – Shishman - Babaj Bokës dhe Brekoc - Bishtazhin.

Në këto terrene në fragmente të shkëputura e shpesh të vogla si rezultat i veprimit antropogjen rriten lloje bimore të ultësirave të cilat hyjnë në kuadër të vegjetacionit të pyjeve respektivisht shkurreve me *shelg* e *plep* por edhe me *verrr e marinë (brukë)* të cilat zhvillohen më tepër përgjatë luginave lumenjve ndërsa në aspektin sintaksonomik i takojnë klasëve *Querco-Fagetea* e *Alnetea glutinosae*, rëndeve *Alnetalia glutinosae* dhe *Populetalia albae* si dhe alencave *Alnion glutinosae*, *Salicion albae* dhe *Populion albae*. Llojet më të shpeshta bimore të këtyre hapësirave në katin e drurëve janë prezente llojet *Salix alba* (dominon), *Populus nigra*, *Ulmus effusa*, *Alnus glutinosa*, *Salix fragilis*. Në katin e shkurreve janë prezente llojet bimore *Salix purpurea*, *Frangula alnus*, *Cornus sanguinea*, *Tamarix tetrandra* ndërsa në katin e bimëve barishtore gjenden llojet bimore *Galium palustre*, *Alisma plantago aquatica*, *Veronica anagallis*, *Mentha aquatica*, *Agrostis alba*, etj.

Gjatë hulumtimit të realizuar në terren (EK / 07-17.09.2018) është konstatuar prezenca e llojit *Quercus robur* (Rrënjë, "Dushku rrënjë"). Prandaj, është e mundur që në të kaluarën këto terrene ishin të mbuluara nga vegjetacioni i dominuar nga fitocenoza *Periploco-Quercetum*

roburis (bashkësia bimore e shkurres *Shtalpër* me *Dushkun rrënjë*) e cila tani nuk gjendet e zhvilluar si fitocenoze.



Quercus robur (Qerim, EK-11.09.2018)

Shumë nga këto hapësira nën ndikimin e faktorit antropogjen tani janë të shndërruara në agroekosisteme (toka të punuara), djerrina apo në livadhe të ultësirave. Në tokat ku punohen kultivohen bimë të ndryshme ushqyese apo edhe industriale, ndërsa ato zënë sipërfaqe të konsiderueshme. Ka edhe hapësira të cilat dikur janë punuar nga njeriu me qëllim të kultivimit të kulturave të ndryshme, ndërsa tani pasi nuk punohen për një periudhë të caktuar kohore gjenden në faza të ndryshme të sukcesionit.

Nëpër këto hapësira të ultësirave pjesë të konsiderueshme u takojnë livadheve të ultësirave të cilat në aspektin sintaksonomik i takojnë aleancës *Trifolion resupinati*, rendit *Trifolio-Hordetalia* dhe klasës *Molinio-Arrhenatheretea* (Hundozi, B. 1980, Rexhepi, F. 1982, 1994, 2007, Krasnqi, E. 2003, 2006, Kastrati, A. 2015). Në këto livadhe janë prezente llojet bimore karakteristike për livadhet e ultësirave si: *Equisetum arvense*, *Equisetum palustre*, *Bellis perennis*, *Taraxacum officinale*, *Tragopogon pratensis*, *Capsella bursa-pastoris*, *Rorippa pyrenaica*, *Dianthus armeria*, *Stellaria graminea*, *Convolvulus arvensis*, *Helianthemum nummularium*, *Euphorbia cyparissias*, *Lotus corniculatus*, *Ononis spinosa*, *Trifolium pratense*, *Trifolium repens*, *Erodium cicutarium*, *Ajuga reptans*, *Mentha longifolia*, *Prunella laciniata*, *Prunella vulgaris*, *Salvia verticillata*, *Plantago lanceolata*, *Plantago media*, *Polygala vulgaris*, *Lysimachia nummularia*, *Ranunculus acris*, *Ranunculus ficaria*, *Ranunculus millefoliatus*, *Filipendula vulgaris*, *Potentilla*

reptans, *Sanguisorba minor*, *Cruciata laevipes*, *Gratiola officinalis*, *Parentucellia latifolia*, *Rhinanthus minor*, *Veronica beccabunga*, *Allium vineale*, *Carex distans*, *Scirpus lacustris*, *Juncus articulatus*, *Juncus effusus*, *Colchicum autumnale*, *Orchis laxiflora*, *Orchis morio*, *Agropyrum repens*, *Alopecurus pratensis*, *Briza media*, *Bromus sterilis*, *Chrysopogon gryllus*, *Cynodon dactylon*, *Cynosurus cristatus*, *Holcus lanatus*, *Lolium perenne*, *Poa pratensis* etj.



Holcus lanatus (Livadhet e Necit. EK-22.05.2014)

Flora dhe vegjetacioni i zonës kodrinore- malore

Zona kodrinore-malore e territorit të komunës së Gjakovës me lartësi mbidetare prej 500-800 (900) m mbulohet nga vegjetacioni në të cilin dominojnë pyjet gjetherënëse të cilat krahasuar edhe me hapësira tjera në kuadër të territorit të Republikës së Kosovës, në aspektin sintaksonomik i takojnë klasës *Querco-Fagetea*, nga rendet *Quercetalia pubescentis*, *Fagetalia sylvaticae*, *Quercetalia roburi petraeae*, *Prunetalia spinosae* nga aleancat *Ostryo-Carpinion orientalis*, *Quercion frainetto*, *Cotino-Cotoneastrion*, *Pruno tenelle-Syringion*, *Fagion moesiacea*, *Quercion roburi-petraeae*, *Berberidion vulgaris* dhe *Cratego-Corylion*.

Ky vegjetacion me llojet dhe fitocenozat karakteristike për klasën *Querco-Fagetea* shtrihet në lokacionet: Jabllanicë-drejtimi i territorit të komunës së Deçanit; rrethi Jabllanicë-Kralan-Rakovinë-Rashkoc-Zhdredhë-Radoniq-Rakoc-drejtimi i territorit të komunës së Deçanit; Bitesh-Palabardh-Sopot-Bec-Rrezinë; Sheremet-Mejë; Dobrosh-Berhjah, Popoc-Smolice-Nec-Shishman; Koshare-Morinë; Zulfaj-Kusar-Lipovec-Pjetërshan-Kushavec-Bishtazhin dhe Damjan-Gerçinë-Goden. Llojet karakteristike nga klasa *Querco-Fagetea* të kësaj hapsire janë: *Quercus frainetto*, *Quercus ceris*, *Quercus pubescens*, *Quercus petraea*, *Quercus trojana*, *Fagus moesiaca*, *Carpinus orientalis*, *Carpinus betulus*, *Fraxinus ornus*, *Acer obtusatum*, *Acer campestre*, *Acer platanoides*, *Sorbus domestica*, *Sorbus torminalis*, *Prunus avium*, *Malus*

sylvestris, *Malus florentina*, *Pyrus pyraster*, *Pyrus amigdaliformis*, *Tilia platyphyllos*, *Acer campestre*, *Corylus colurna*, *Ostrya carpinifolia*, *Castanea sativa*, *Cotinus coggygria*,



Castanea sativa (Koshare. EK-12.09.2018)

Crataegus monogyna, *Cornus mas*, *Corylus avellana*, *Rosa canina*, *Viburnum lantana*, *Ligustrum vulgare*, *Acer tataricum*, *Prunus spinosa*, *Clematis flamula*, *Evonymus europaea*, *Evonymus verrucosus*, *Dioscorea balcanica*, *Lathyrus niger*, *Stachys scardica*, *Ajug laxmannii*, *Inula salicina*, *Acanthus balcanicus*, *Sideritis montana*, *Aristolochia pallida*, *Veronica chamaedrys*, *Coronilla scorpioides*, *Primula acaulis*, *Lithospermum purpureo-coeruleum*, *Euphorbia amygdaloides*, *Campanula persicifolia*, *Eryngium palmatum*, *Stellaria holostea*, *Ruta graveolens*, *Euphorbia myrsinites*, *Helleborus odorus*, *Helleborus multifidus*, *Galium sylvaticum*, *Dactylis glomerata*, *Melica uniflora*, *Fragaria vesca*, *Inula oculus-christi*, *Clinopodium vulgare*, *Paeonia coralina*, *Pteridium aquilinum*, *Trifolium alpestre*, *Trifolium montanum*, *Viola odorata* etj. (Krasniqi, F. 1972, Rexhepi, F. 1982, 1994, 2007, Krasnqi, E. 2003, 2006).

Në Masivin malor në relacionin Qafë e Morinës-Qafë e Prushit, në Ponoshec, në Hereç etj. rriten lloje bimore të cilat i takojnë vegjetacionit të substrateve serpentine të cilat janë mjaft specifike ndërsa në aspektin sintaksonomik i takojnë rendit *Quercetalia pubescentis* me aleancën *Pruno tenelle-Syringion* si dhe rendit *Halacsyetalia sendtneri* me gjasë me elemente nga aleanca *Centaureo-Bromion fibrosi*. Në këto terrrene rriten llojet bimore: *Forsythia europaea*, *Quercus pubescens*, *Fraxinus ornus*, *Quercus cerris*, *Quercus petraea*, *Pinus nigra*, *Tamarix tetrandra*, *Juniperus oxycedri*, *Juniperus communis*, *Centaurea albertii*, *Cerinthe minor*, *Stachys scardica*,

Euphorbia glabriflora, *Polygala doerfleri*, *Salvia ringens*, *Sanguisorba albanica*, *Potentilla visianii*, *Centaurea kosanini*, *Alyssum markgraffi*, *Aster albanicus*, *Sedum serpentini*, *Linum elegans*, *Linum tauricum*, *Erica carnea*, *Halacsya sendtneri*, *Potentilla astracantha*, *Galium lucidum*, *Dorycnium herbaceum*, *Scorsonera austriaca*, *Euphorbia myrsinites*, *Inula hirta*, (Krasniqi, F. 1972, Rexhepi, F. 1982, 1994, 2007, Krasnqi, E. 2003, 2006, Pjetraj, P. 2016).



Aster albanicus (Morinë. EK-15.09.2018)

Gjatë ekspeditave hulumtuese të vitit 2018, në rrëzat e Pashtrikut në relacionin Gerçinë-Lipovec) janë konstatuar hapësira fragmentare me vegjetacion të fitocenezës *Dioscoreo-Carpinetum orientalis* (Ekspeditë hulumtuese EK / 07-17.09.2018).

Në **terrenet me lartësi mbidetare 1000-1500 m** sidomos në drejtim të Pashtrikut (relacioni Gerçinë-Pashtrik si dhe Goden-Pashtrik) dhe në pjesën e Bjeshkëve të Namuna (nga Brovina, Mulliqi, Batusha e Kosharja në drejtim të bjeshkëve të larta) paraqiten hapësira me lloje bimore të cilat i formojnë pyjet e *ahut* (*Fagetum moesiaca montanum*) të cilat në disa raste përzihen edhe me drurë *halorë* (Rexhepi, F. 1982, 1994, 2007).

Në **terrenet më të larta malore me lartësi mbidetare mbi 1500 m** gjithashtu në Bjeshkët e Nemuna rriten llojet bimore të cilat i formojnë *pyjet halore*, ndërsa përfundojnë në pjesët më të larta përfundojnë me *kullosa subalpine-alpine* (Rexhepi, F. 1982, 1994, 2007).

Në disa hapësira të territorit të komunës së Gjakovës ka sipërfaqe të cilat janë të mbuluara me bimë të kultivuara sidomos me lloje nga bimët drunore *halore* kryesisht nga gjinia *Pinus*. Raste të tilla janë **Kompleksi i Pishes së zezë në Shkukëz** si dhe **hapësira në rrethinën e Mulliqit** (rrethi Mulliq-Brovinë-Pomoshec-Morinë) (EK / 07-17.09.2018).



Pinus nigra (Shkukëz. EK-14.09.2018)

Hapësirat territoriale në komunën e Gjakovës të cilat janë më të pasura me fitodiversitet janë ato në drejtim të Pashtrikut dhe pjesa e Bjeshkëve të Nemuna. Rëndësia e kësaj mbulese bimore të lartëpërmendur qëndron në faktet se ato kanë rëndësi shkencore (si relikte, endemike, klimazonale), disa kanë vlera ekonomike (për kullosë, për ushqim, për mjekësi, për ndërtimtari), disa janë me rëndësi për ruajtjen e tokës (dheut) nga erozioni.

Kjo mbulesë bimore si tërësi, diku më shumë e diku më pak, është nën ndikimin negativ të faktorëve të ndryshëm me theks të veçantë faktorët zooantropogjenë, realisht duhet të realizohet zhvillim i qëndrueshëm prandaj duhet vepruar në dobi të mbrojtjes së saj (EK / 07-17.09.2018).

Sipas Ivo Horvat (Rexhepi, F.1982) “*Vegjetacioni ose mbulesa bimore cakton pamjen, ekologjinë dhe rëndësinë ekonomike të vendit. Ai është i varur prej relievit të ndryshëm, klimës, tokës dhe faktorëve të ndryshëm antropogjenë. Prandaj, çdo ndërmjetësim ekonomik në vegjetacion në formë të shfrytëzimit të tij ose meliorimit kërkon njohje detaje*”.


9.1.2. Fauna në komunën e Gjakovës

Ichtiofauna e Gjakoves

1. *Eudontomyzon stankokaramani* Karaman, 1974 (peshku me shtate vrima, kavalli). Gjendet në Erenik, Trava, Prroni i Necit. Ky lloj duhet të futet në listën e llojeve të mbrojtura pasi është endemik për Drinin e Bardhë.
2. *Rhodeus meridionalis* Karaman, 1924, (Idhëtaku). Nuk ka masa mbrojtëse ndërsa është konstatuar në Erenik (te Ura e Terzive).



3. *Phoxinus phoxinus* (Linnaeus, 1758) (Skort pellgjes). Gjendet në Llukac ndërsa nuk ka masa mbrojtëse.
4. *Barbus barbus* L. 1758 (Mrena). Gjendet në Radoniq.
5. *Pachychilon pictum* (Heckel & Kner, 1858)(Skorti i zi). Gjendet te Ura e Fshajtë, në Erenik, ndërsa nuk ka masa mbrojtëse.
6. *Alburnoides bipunctatus* (Bloch, 1782), (Peshku barkgjerë). Gjendet te Ura e Fshajtë, Erenik, nuk ka masa mbrojtëse.
7. *Squalicus cephalus* (Linnaeus, 1758),(Klenori). Gjendet në Erenik, Rogovë ndërsa nuk ka masa mbrojtës.
8. *Leuciscus leuciscus* (Linnaeus, 1758), (Melyshi) Gjendet te Ura e Fshajtë, nuk ka masa mbvrotëse.
9. *Leucaspis delineatus* (Heckel, 1843), (Mlyshi-Belica). Gjendet në Radoniq.
10. *Barbus rebeli* Koller, 1926 (Mrena). Gjendet në Radoniq, te Ura e Fshajtë.
11. *Chondrostoma nasus* (Linnaeus, 1758) (Skobuzi, Njila malore). Gjendet në Radonic, te Ura e Fshajtë.
12. *Cyprinus carpio* Linnaeus, 1758 (Krapin). Gjendet në Ura e Fshajtë dhe në Radoniq.
13. *Carassius gibelio* (Bloch, 1782) (Karashi i artë). Gjendet në Radoniq dhe te Ura e Fshajtë.
14. *Scardinius erythrophthalmus* (Linnaeus, 1758) (Lloska, Bravica). Gjendet te Ura e Fshajtë dhe në Radoniq.
15. *Ctenopharyngodon idella* (Valenciennes, 1844) (Amuri i bardhë). Gjendet në Erenik, është e afërme me krapin.
16. *Gobio gobio* L.1758 (Mustaku). Gjendet në Erenik dhe në Radoniq.
17. *Pseudorasbora parva* (Temminck & Schlegel, 1846) (Iloj mlyshi). Gjendet në Erenik.
18. *Alburnus alburnus* (Linnaeus, 1758) (Gjica, Cironka). Gjendet në Erenik dhe në Radoniq.
19. *Rutilus rutilus* (Linnaeus, 1758) (Skorti , Gurreneci, Sykuqi). Gjendet në Radoniq.



Cobitis ohridana Karaman (Mrena e egër)

20. *Cobitis ohridana* Karaman, 1928 (Mrena e egër). Gjendet në Erenik.
21. *Sabanejewia balcanica* (Karaman, 1922). Gjendet në Gjakovë, Retusha.
22. *Cottus gobio* Linnaeus, 1758 (Veshori). Gjendet te Ura e Fshajtë.
23. *Perca fluviatilis* Linnaeus, 1758 (Sharroku). Gjendet te Ura e Fshajtë dhe në Radoniq.
24. *Salmo trutta* Linnaeus, 1758, (Trofta). Gjendet në Krena.

Herpetofauna e Gjakoves

Ujëtokësorët (Amphibia)

Ujëtokësorët me bisht - Caudata:

1. *Salamandra atra* (Lur. 1768) (*Picrraku i zi*).
2. *Salamandra maculosa* (Laur. 1768); (*E bukura e dheut*).



Salamandra maculosa (*E bukura e dheut*)

3. *Triturus vulgaris* (Linne, 1758) (*Tritoni i rëndomt*).
4. *Triturus alpestris* (Laur. 1768) (*Tritoni*).
5. *Triturus cristatus* (Laur. 1768) (*Tritoni*).

Ujëtokësorët pa bisht - Eucaudata:

1. *Rana ridibunda* (Pallas, 1771) (*Bretkosa e kënetave*).
2. *Rana graeca* (Boulenger, 1891) (*Bretkosa greke*).
3. *Rana dalmatina* (Bonaparte, 1839) (*Bretkosa dalmatine*).
4. *Rana temporaria* (Linne, 1758) (*Bretkosa tokësore*).
5. *Bufo vulgaris* (Laur. 1768).
6. *Bufo viridis* (Laur. 1768).
7. *Bombinator pachypus* (Bonaparte, 1878).

Reptilia ose rrëshqitësit

1. *Vipera ammodytes* (Linnaeus, 1758) (*Neperka, Hundraku*).
2. *Natrix natrix* (Linnaeus, 1758) (*Gjarpëri i barit*).
3. *Natrix tessellata* (Laurenti, 1768) (*Gjarpëri i ujit*).
4. *Dolichophis caspius* (Gmelin, 1789) (*Gjarpëri shigjetë*).
5. *Coronella austriaca* Laurenti, 1768 (*Gjarpëri i butë*).
6. *Zamenis longissimus* (Laurenti, 1768) (*Bolla e shtëpisë*).
7. *Testudo hermanni* Gmelin, 1789) (*Breshka e zakonshme*).

8. *Algyroides nigropunctatus* (Duméril and Bibron, 1839) (*Hardhuca e shkëmbinjëve*)
9. *Emys orbicularis* (Linnaeus, 1758) (*Breshkujcë*)
10. *Podarcis muralis* (Laurenti, 1768) (*Hardhuca e mureve*)
11. *Lacerta agilis* Linnaeus, 1758 (*Hardhuca e shpejtë*)
12. *Lacerta viridis* (Laurenti, 1768) (*Hardhuca e gjelbër*)
13. *Anguis fragilis* (Linnaeus, 1758) (*Kogezageza*)
14. *Podarcis tauricus* (Pallas, 1814) (*Hardhuca e barit*)



Vipera ammodytes

Shpezet (Aves)

Regjioni i Gjakoves është poashtu i pasur me nje shumllojshmëri të shpezëve (mbi 150 lloje) ku pjesen me te madhe e dominojne shpëzët këngëtare (familja *Corvidae*, *Paridae* , *Motacillidae*, *Turdidae*, *Sylvidae*, *Lanidae*, *Hirundinidae*, *Columbidae*,etj) pastaj grabitesit e vertete te sistemtizuar ne rendin *Falconiformes* me familjet *Aqualidae* dhe *Falconidae*. Disa prej shpezeve janë të përhershme (*harabelat*, *pellumbi i eger*, *kumria* , *pikthat*, *kukuvajka* , *huti*, përfaqësues të familjes *corvidae* etj). Disa prej tyre vijnë gjatë verës (Mars-Prill e qëndrojnë deri në shtator-tetor, e disa tjera vijnë në vjeshtë dhe qëndrojnë deri në pranverë ose disa tjera që shihen kalimthi dhe mund të shihen ose në pranvere apo edhe në vjeshtë. Disa shpezë ndonjëherë mund edhe të jenë të dëmshme duke u ushqye me fara dhe frute të ndryshme të pemëve, me fara dhe



frute të drithrave duke ju shkaktua dëme të mbjellave dhe kopshtijeve, pastaj me vezë dhe të vegjël të shpezëve shtëpijake, por në të njëjtën kohë të njejtat shpezë me sukses i shfarosin shumë larva dhe vezë insektesh të cilat i shkatojnë dëme mjaft të mëdha pemëve dhe kulturave tjera bujqësore, disa prej tyre ushqehen me brejtës të vegjël të cilët poashtu i shkatojnë dëme të mëdha të lashtave bujqësore. Pra në këte rast dobia është më e madhe se dëmi i tyre prandaj duhet edhe të kujdesemi për to.



Streptopelia decaocto (Kumria)

Gjitaret (Mammalia)

1. *Vulpes vulpes* (Linnaeus, 1758) (*Dhelfera*).
2. *Canis lupus* (Linnaeus, 1758) (*Ujku*).
3. *Ursus arctos* (Linnaeus, 1758) (*Ariu i murrme*).
4. *Sciurus vulgaris* (Linnaeus, 1758) (*Ketri*).
5. *Mustela nivalis* (Linnaeus, 1766) (*Nuselala*).
6. *Lutra lutra* (Linnaeus, 1758) (*Vidra ose Lundërza*).
7. *Lepus europaeus* (Pallas, 1778) (*Lepuri*).
8. *Mustela putorius* Linnaeus, 1758) (*Qelbsi*).
9. *Martes martes* (Linnaeus , 1758)) *Shqarshi ose Kunadhja gushëbardhë*).
10. *Capreolus capreolus* (Linnaeus, 1758) (*Kaprolli*).
11. *Meles meles* (Linnaeus, 1758) (*Vjedulla*).
12. *Mustela erminea*(Linnaeus, 1758) (*Nuselala e borës*).
13. *Sus scrofa* (Linnaeus, 1758) (*Derri i eger*).
14. *Talpa caeca* (Savi, 1822) (*Urithi*)
15. *Erinaceus roumanicus* (Barret-Hamilton, 1900) (*Iriqi*).
16. *Canis aureus* (Linnaeus, 1758) (*Cakalli*).
17. *Felis silvestris* (Schreber, 1777) (*Maca e eger*).
18. *Vespertilionidae* (*Lakuriqet*).



Capreolus capreolus (Kaprolli) (DR-2018)

9.1.3. Zonat e mbrojtura dhe të propozuara përmbrojtje ligjore

Zonat e mbrojtura me ligj nga territori i komunës së Gjakovës

Për shkak të vlerave të trashëgimisë natyrore rreth 5% (afro 3000 ha) të Parkut Nacional “Bjeshkët e Namuna” shtrihen në territorin e komunës së Gjakovës. Poashtu në kuadër të territorit të KK të Gjakovës në kuadër të diversitetit biologjik ka vlera të trashëgimisë natyrore të cilat janë të mbrojtura me ligj por edhe të propozuara për mbrojtje me ligj. Në territorin e komunës së Gjakovës janë edhe 3 zona tjera të Mbrojtura me Ligj (“Çabrati”, “Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë” dhe “Shkukëza”) (AKMM - IKMN 2008, 2010). Është në procedurë të futjes nën mbrojtje edhe një pjesë e territorit të komunës së Gjakovës në rrëzat e Pashtrikut (relacionin Gërçinë-Pashtrik).

Zonat e propozuara për mbrojtje me ligj nga territori i komunës së Gjakovës

Nga territori i komunës së Gjakovës, IKMN në vitin 2003 ka propozuar 28 zona për marrje nën mbrojtje ligjore. Këto paraqesin vlera të trashëgimisë natyrore të cilat në mënyrë direkte apo indirekte është fjala edhe për vlera të biodiversitetit.

Këto zona janë:

1. Parku regjional “Pashtriku”,
2. Parku pyjor “ Maja e Gllavës”,
3. Kompleksi i pishes së zezë në Shkukëz,
4. Lisi i qarrit në fshatin Hereq,



-
5. Trungu i blirit në fshatin Stubëll,
 6. Blirat e Berjahës në fshatin Berjah,
 7. Lisi i bungut në fshatin Dobrosh,
 8. Trungu i blirit dhe qarrit në fshatin Rracaj,
 9. Lisi i qarrit në fshati Vogovë,
 10. Burimi në fshatin Molliq,
 11. Burimi i lumit Deshtica “Gurra e Demjanit”,
 12. Burimi në fshatin Kusar,
 13. Burimi në fshatin Potok (1),
 14. Shpella e Qiriut,
 15. Shpella e Kusarit,
 16. Përbërja e bashkësisë së brukës,
 17. Lokaliteti i bujgërit dhe i Dioskoresë,
 18. Lokaliteti i lule bozhures në Pashtrik,
 19. Lugu i Tisit,
 20. Bashkësitë e boshtres dhe të gështenjës në degët e Bjeshkëve të Nemuna.
 21. “Zabeli i Gojanit” në fshatin Shqiponjë,
 22. Trungu i qarrit në fshatin Gërçinë,
 23. Trungjet e bungut dhe të qarrit në fshatin Molliq,
 24. Trungu i qarrit në fshatin Madanaj,
 25. Trungu i bungut në fshatin Bec,
 26. Trungjet e bungut dhe qarrit në fshatin Zhabel,
 27. Trungjet e bungut dhe qarrit në fshatin Gërgoc,
 28. Burimi në fshatin Potok (2).



Zonat e propozuara përmbrojtje me ligj në komunën e Gjakovës (IKMN-2003)

Nr	Vendi	Objekti	Pika	Kor. X	Kor. Y	L.mb idet	Ora	Data	Komuna
1	Shqiponjë	Zabeli i Gojanit	1	0457445	4710056	455	12:10	27.12.2002	Gjakovë
2	Gjakovë	Çabrati	1	0452315	4692101	453	12:15	05.02.2003	Gjakovë
3	Molliq	Kompleks i trungjeve	1	0439809	4698901	485	11:45	12.02.2003	Gjakovë
4	Molliq	Shpella e Arushës	2	0439481	4699120	549	11:55	12.02.2003	Gjakovë
5	Molliq	Burim i ujit	3	0439883	4699228	510	13:00	12.02.2003	Gjakovë
6	Potok (Morinë)	Burimi i ujit	1	0438110	4697578	490	12:25	12.02.2003	Gjakovë
7	Potok (Morinë)	Burimi i ujit	2	0437919	4697975	505	12:35	12.02.2003	Gjakovë
8	Berjah	Trungjet e blirit	1	0441594	4697156	450	13:15	12.02.2003	Gjakovë
9	Stubëll	Trungu i blirit	1	0441744	4695768	440	13:40	12.02.2003	Gjakovë
10	Kusar	Shpella e Novakut	1					26.02.2003	Gjakovë
11	Kusar	Shpella e Kusarëve	2					26.02.2003	Gjakovë
12	Fierzë	Parku i Shkukëzës	1	0452276	4689964	385	13:30	04.03.2003	Gjakovë
13	Vogovë	Trungu i qarrit	1	0449828	4688441	415	14:15	04.03.2003	Gjakovë
14	Gërçinë	Trungu i qarrit	1	0457334	4683290	510	11:30	06.03.2003	Gjakovë
15	Gërçinë	Trungu i blirit	2	0437509	4682968	533	12:10	06.03.2003	Gjakovë
16	Gërçinë	Shpella e Xhytezes	3	0456082	4682102	872	14:00	03.04.2003	Gjakovë
17	Demjan	Gurra e Demjanit	1	0460017	4681802	368	12:45	06.03.2003	Gjakovë
18	Madanaj	Trungu i qarrit	1	0448090	4694639	405	11:10	13.03.2003	Gjakovë
19	Madanaj	Trungu i shkozës	2	0448136	4694332	392	11:20	13.03.2003	Gjakovë
20	Rracaj	Trungu i blirit dhe qarrit	1	0446693	4696522	417	12:15	13.03.2003	Gjakovë
21	Dobrosh	Trungjet e blirit	1	0443408	4699029	490	12:50	13.03.2003	Gjakovë
22	Dobrosh	Trungu i qarrit	2	0443383	4698692	485	13:05	13.03.2003	Gjakovë
23	Dobrosh	Trungu i blirit	3	0442904	4698356	478	13:20	13.03.2003	Gjakovë
24	Marmull	Bashkësia e Brukës	1	0454881	4699580	379			
24	Hereq	Trungu i qarrit	1	0447243	4701689	481	12:15	18.03.2003	Gjakovë
25	Bec	Trungu i bungut	1	0454881	4699580	379	11:00	28.03.2003	Gjakovë
26	Bec	Trungu i bungut	2	0454290	4700318	390	11:20	28.03.2003	Gjakovë
27	Palabardh	Trungu i qarrit	3	0451189	4701462	462	13:50	28.03.2003	Gjakovë
28	Zhabel	Kompleks i trungjeve	1	0455954	4709173	435	10:45	03.04.2003	Gjakovë
29	Gërgoc	Kompleks i trungjeve	1	0455062	4705820	473	11:10	03.04.2003	Gjakovë
30	Koshare	Maja e Gllavës	1					25.03.2003	Gjakovë

9.1.4. Lloje bimore nga Libri i kuq i florës vaskulare të Republikës së Kosovës

Bazuar në Librin e kuq të florës vaskulare të Republikës së Kosovës (Millaku, F. et al, 2013), të vlerësuara sipas shkallës së kërcënueshmërisë sipas IUCN, në territorin e komunës së Gjakovës rezultojnë të jenë prezente 33 lloje bimore nga flora vaskulare (prej tyre 7 lloje konstatohen në lokalitete të reja në territorin e komunës së Gjakovës (EK / 07-17.09.2018).



Pinguicula crystallina Sm. subsp. *hirtiflora* (Ten.) Strid. (*Pinguikulë lulekreshtë*)
(Morinë. EK-19.04.2013)

Lloje bimore nga Libri i kuq i florës vaskulare të Republikës së Kosovës

Nr.	Lloji bimor	Lokaliteti në komunën e Gjakovës (Libri i kuq i florës vaskulare të republikës së Kosovës)	Kërcënueshmëria (sipas IUCN)	Lokalitete të reja
1.	<i>Romulea bulbocodium</i> (L.) Sebastiani & Mauri (<i>Lulekabuni</i>)	Babaj i Bokës	CR - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar në mënyrë kritike.	
2.	<i>Daphne blagayana</i> Freyer (<i>Xerxele e Bllagajt</i>)	Morinë	EN - B2ab(i,ii,iii,iv) – I Rrezikuar.	
3.	<i>Dioscorea balcanica</i> Kusanin (<i>Groshë e egër, Dioskorea ballkanike</i>)	-	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) – I Rrezikuar.	EK 2018
4.	<i>Gentiana pneumonanthe</i> L. subsp. <i>nopcsae</i> (Jav.) T. Wraber (<i>Gencianë e Nopçes</i>)	Morinë	EN - B1ab(i,ii,iii,iv)+2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar.	



5.	<i>Gladiolus illyricus</i> W.D.J. Koch (<i>Gladiola e Ilirisë</i>)	Morinë.	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar.	
6.	<i>Haplophyllum boissertianum</i> Vis. et Panc. (<i>Haplofil i buasierit</i>)	Morinë.	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar.	
7.	<i>Micromeria albanica</i> (K. Maly) Silic (<i>Bishtmii shqiptar</i>)	Te Ura e Fshajtë.	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar.	
8.	<i>Minuartia baldaccii</i> (Hal.) Mattf., subsp. baldacci (<i>Minuarte e Baldaçit</i>)	Morinë, Ura e Fshajtë.	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar.	
9.	<i>Paeonia mascula</i> (L.) Mill. (<i>Lule bozhure mashkull</i>)	-	EN B2ab(i,ii) - I Rrezikuar.	EK 2018
10.	<i>Pinguicula crystallina</i> Sm. subsp. <i>hirtiflora</i> (Ten.) Strid. (<i>Pinguikulë lulekreshtë</i>)	Morinë.	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar.	
11.	<i>Quercus robur</i> L. subsp. <i>robur</i> (Rrënjë)	-	EN - B2ab(i,ii,iii,iv); D – I Rrezikuar.	EK 2018
12.	<i>Sanguisorba albanica</i> Andrasovzky et Jav. (<i>Sanguisorbë shqiptare</i>)	Morinë.	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) – I Rrezikuar.	
13.	<i>Aster albanicus</i> (Degen) Degen (<i>Aster shqiptar</i>)	Qafë Prush, Pllanik-Morinë.	VU B2a – I Përkeqësuar	
14.	<i>Centaurea albertii</i> Rexhepi (<i>Kokoçeli i Albertit</i>)	Devë.	VU – D2 – I Përkeqësuar	
15.	<i>Epimedium alpinum</i> L. (<i>Epimedë alpine</i>)	Morinë.	VU D2 – I Përkeqësuar	
16.	<i>Linum elegans</i> Spruner ex Boiss. (<i>Lini i hijshëm</i>)	Ponoshec. Morinë.	VU – D2 - I Përkeqësuar	
17.	<i>Malus florentina</i> (Zucc.) C.K. Schneider (syn.: <i>Sorbus florentina</i> Nym.) (<i>Mollë florentine</i>)	-	VU- B1ab(i,ii,iii,iv)+2ab(i,ii,iii,iv) – I Përkeqësuar	EK 2018
18.	<i>Clematis flammula</i> L. (<i>Kulpër e butë</i>)	-	NT – Gati i rrezikuar.	EK 2018
19.	<i>Linaria genistifolia</i> subsp. <i>dalmatica</i> (L.) Maire & Petitm. (<i>Linaria dalmate</i>)	Morinë.	NT – Gati i rrezikuar.	
20.	<i>Moltkia doerfleri</i> Wettst. (<i>Moltkë e Dërflerit</i>)	Morinë.	NT – Gati i rrezikuar.	
21.	<i>Potentilla visianii</i> Panc. (<i>Potentillë e Visianit</i>)	-	NT – Gati i rrezikuar.	EK 2018
22.	<i>Quercus trojana</i> Webb in Loudon (<i>Qarrazë</i>)	-	NT – Gati i rrezikuar.	EK 2018 !
23.	<i>Salvia ringens</i> Sibth.et Sm. (<i>Sherbelë kurorëhapur</i>)	Morinë.	NT – Gati i rrezikuar	
24.	<i>Saponaria sicula</i> Rafin. subsp. <i>intermedia</i> (Simmler) Chater. (<i>Sapunqyqe me spica</i>)	Pllanik (Ponoshec), Morinë.	NT – Gati i rrezikuar.	
25.	<i>Sedum serpentini</i> Janch.	Pllanik, Morinë.	NT – Gati i rrezikuar.	



	(<i>Rrushqyqe e serpentineve</i>)			
26.	<i>Veronica andrasovszkyi</i> Jav. [<i>V. spicata</i> L. subsp. <i>barrelieri</i> (Schott ex Roemer & Schultes) Murb.] (<i>Veronikë e Andrazovskit</i>)	Devë, Morinë.	NT – Gati i rrezikuar.	
27.	<i>Centaurea kosaninii</i> Hayek. (<i>Kokoçel i Koshaninit</i>)	Qafa e Prushit, Morinë.	LC – më pak i Rrezikuar	
28.	<i>Forsythia europaea</i> Deg. et Bald. (<i>Boshtër</i>)	Qafa e Prushit, Morinë.	LC – më pak i Rrezikuar	
29.	<i>Halacsya sendtneri</i> (Boiss.) Dorbl. (<i>Halaçi i Sendtnerit</i>)	Qafa e Prushit, Morinë.	LC – më pak i Rrezikuar	
30.	<i>Lilium albanicum</i> Griseb. (<i>Zambaku shqiptar</i>)	Morinë.	LC – më pak i Rrezikuar	
31.	<i>Linum flavum</i> L. (<i>Liri i verdhë</i>)	Morinë, Qafë Prush.	LC – më pak i Rrezikuar	
32.	<i>Polygala doerfleri</i> Hayek (<i>Poligalë e Dorflerit</i>)	Morinë, Qafë Prush.	LC – më pak i Rrezikuar	
33.	<i>Scabiosa fumaroides</i> Vis. et Panc. (<i>Skabiozë si fomi</i>)	Morinë.	LC – më pak i Rrezikua	

9.1.5. Lloje shtazore të mbrojtura me ligj

Në kuadër të mbrojtjes së vlerave të diversitetit biologjik të Republikës së Kosovës, janë të mbrojtura edhe lloje nga bota shtazore, ndërkohë që është në hartim e sipër Libri i kuq i faunës së Kosovës.

Nga lista e llojeve shtazore të cilat janë në Anex II të Direktivës së Habiteteve (92/43/EEC) ka edhe lloje prezente në teritorin e komunës së Gjakovës. Këto lloje janë: *Salamandra atra* (*Picrraku i zi*), *Triturus cristatus*, *Natrix natrix*, *Testudo hermani*, *Emys orbicularis*, *Canis lupus* (*Ujku*), *Ursus arctos* (*Ariu i murrmë*), *Lutra lutra* (*Vidra, Lundërza*), *Capreolus capreolus* (*Kaprolli*).

Deri më tani lloje shtazore të mbrojtura me ligj në Republikën e Kosovës dhe që gjenden edhe në territorin e komunës së Gjakovës janë llojet: *Ursus arctos* (*Ariu i murrmë*), *Sciurus vulgaris* (*Ketri*), *Martes foina* (*Sqarthi, Kunadhja gushbardhë*), *Capreolus capreolus* (*Kaprolli*) dhe *Felis silvestris* (*Macja e egër*).



Ursus arctos (*Ariu i murrmë*) (DR-2018)



10. PROPOZIMI I MASAVE PËR MENAXHIM TË QËNDRUESHËM TË BIODIVERSITETIT

Me qëllim të shfrytëzimit të qëndrueshëm përmes menaxhimit të qëndrueshëm (mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm) të biodiversitetit në hapësirën e komunës së Gjakovës, nevojite zbatimi i masave si në vijim:

- ✓ *Plotesimi i bazës ligjore për menaxhimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";*
- ✓ *Përgatitja e hartave të territotit të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (Plani hapësinor dhe Plani menaxhues);*
- ✓ *Forcimi i zbatimit të ligjeve nga gjithë akterët/grupet e interesit (institucionet shtetërore, subjektet politike, qytetarët, biznesi, OJQ, etj.).*
- ✓ *Vetëdijësi i qytetarëve për mbrojtjen e ruajtjen e vlerave natyrore (përmes fushatave në mediat elektronike e të shkruara, edukimi ekologjik, etj.)*
- ✓ *Zhvillimi i turizmit në përputhje me kriteret mjedisore (ligjet vendore dhe konventat ndërkombëtare);*
- ✓ *Veprimtaritë ekonomike në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" si: blegësia, bletaria, pemtaria, eko-turizmi, prodhimi i ushqimit tradicional, artizanatet, etj.*

Lista e projekteve afatmesme për biodiversitetin për PLVB 2019-2024

Caku/ objekti	Ç'farë, ç'ka?	Kush?	Kur?	Burimet /mjetet	Përfshirja e palëve të interesit
Mbjellja e fidaneve (Drurë e shkurre)	Bli, Rrap, Frashër, etj. në qytet	Komuna e Gjakovës	2019-2020	Buxheti komunal 55 000 Eu	Komuna e Gjakovës, Qytetarët, Bizneset OJQ
Projekte pilot të eko-turizmit	Përzgjedhja e lokacioneve për ekoturizëm	Komuna e Gjakovës, Bozneset, Komuniteti, OJQ	2019-2020	Buxheti komunal 35 000 Eu	Komuna e Gjakovës, Bizneset, F fermerët, Komunitet i OJQ
Pastrimi, i prurjeve inerte të Lumit Krena	Vlerësimi i gjendjes, tenderimi	Komuna e Gjakovës, Bozneset, Komuniteti,	2019-2020	Buxheti komunal 45 000 Eu	Komuna e Gjakovës, Bizneset, F fermerët,



		OJQ			Komunitet i OJQ
Përditësimi i regjistrimit të subjekteve që derdhen ujëra të përdorura ndotëse tek lumenjtë e Gjakovës	Identifikimi (GPS koordinatat) përlllogaritje e sasive të ujit të përdorur të ndotur (me pyetësor)	Komuna e Gjakovës, OJQ, MMPH	2019-2020	40,000 euro	Komuna e Gjakovës, Bizneset, OJQ
Vetëdijësimi për njohjen dhe Mbrojtjen e llojeve të rrezikuara bimore	Përcaktimi i llojeve bimore të rrezikuara	MMPH, MBPZHR, Kuvendi komunal	2019-2020	85,000 euro Ministrinë dhe donatorët	Qeveria, MMPH, MBPZHR, Komuna e Gjakovës, Qytetarët, Biznesi, OJQ
Vetëdijësimi për njohjen dhe Mbrojtjen e llojeve të rrezikuara shtazore	Përcaktimi i llojeve shtazore të rrezikuara	MMPH, MBPZHR, Kuvendi komunal	2019-2020	90,000 euro Ministrinë dhe donatorët	Qeveria, MMPH, MBPZHR, Komuna e Gjakovës, Qytetarët, Biznesi, OJQ
Vetëdijësimi për shfrytëzimin e qëndrueshëm të bimëve mjekësore dhe aromatike	Identifikimi i hapësirave potenciale dhe Përcaktimi i llojeve bimore mjekësore dhe aromatike	MMPH, MBPZHR, Kuvendi komunal	2019-2020	75,000 euro Ministrinë dhe donatorët	Qeveria, MMPH, MBPZHR, Komuna e Gjakovës, Qytetarët, Biznesi, OJQ

Lista e projekteve një vjeçare për biodiversitetin për vitin 2020

Caku/ objektivi	Ç'farë, ç'ka?	Kush?	Kur?	Burimet /mjetet	Përfshirja e palëve të interesit
Vetëdijësimi për njohjen dhe Mbrojtjen e llojeve të rrezikuara bimore dhe shtazore	Vetëdijësimi lidhur me llojet e rrezikuara bimore dhe shtazore	Komuna e Gjakovës, OJQ, MMPH	2019-2020	25,000 euro Ministrinë dhe donatorët	Komuna e Gjakovës, Bizneset, OJQ, Komuniteti
Popullimi i rrjedhave ujëmbledhëse me peshq	Identifikimi i lumenjve, dhe përcaktimi i vendeve ku do të hidhen hurdhat e	Komuna e Gjakovës, shoqëria civile dhe biznesi	2019	22,000 euro	Komuna e Gjakovës, shoqata e peshkatarëve, dhe komuniteti



	peshqve (trofte lokale etj.)				
Studimi i fizibilitetit të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA)	Identifikimi i zonës, i llojeve, Zbatimi i projektit (zonimi)	Komuna e Gjakovës, OJQ, qendrat grumbulluese të BMA	2019	20,000 euro	Komuna e Gjakovës, Grumbulluesit, OJQ, Komuniteti



11. SHTOJCA

Fjalorthi i shkurtesave

92/43/EEC	Council Directive 92/43/EEC of 21 May 1992 on the conservation of natural habitats and of wild fauna and flora
AKMM	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
ASHAK	Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DR	Daut Rexhepaj
DSHP	Departamenti i Shërbimeve Publike
DUMM	Departamenti i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
EK	Elez Krasniqi
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
GZ	Gazeta zyrtare
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IUCN	Unionin Botëror për Ruajtjen e Natyrës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
OJQ	Orfganizata Joqeveritare
PLVB	Plani Lokal për Veprim në Biodiversitet
REC	Regional Environmental Center (Qendra Rajonale e Mjedisit)
SIDA	Agjencionin Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës



12. LITERATURA

1. ASK (2013): Vlerësim (Popullsia e Kosovës 2011). Prishtinë.
2. ASHAK-Grup autorësh (2018): Leksikon. Vendbanimet e Kosovës. Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale. Vëllimi I. Qendrat urbane. ASHAK.Prishtinë.
3. Çavolli, R. (1997): Gjeografia regjionale e Kosovës. ETMMK. Prishtinë.
4. Hundozi, B. (1980): Vegetacija niskih livada na Kosovu. Doktorska disertacija. PMF-Sveucilista i Zagrebu. Zagreb.
5. K.K. Gjakovë (2008): Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban i Gjakovës (Municipal and Urban development Plan of Gjakova) 2006-2015+. Gjakovë.
6. Kastrati, A. (2015): Flora vaskulare e Livadheve të Necit. Punim i masterit. UP-FSHMN. Prishtinë.
7. Kojic, M. & Pejcinovic, D. (1982): Korovska flora i vegetacija Kosova. ZUNSSAPK. Pristina.
8. Krasniqi, E. (2003): Flora vaskulare e Rajonit të Mirushës. Punim i magjistraturës. UP-FSHMN. Prishtinë.
9. Krasniqi, E. (2006): Flora dhe vegjetacioni i Malit Drenicë. Disertacion i doktoratës. UP-FSHMN. Prishtinë.
10. Krasniqi, F. (1972): Sumska vegetacija brdskog regiona Kosova. ZNUK. Studije. Knj.27. Prishtinë
11. Krasniqi, M. (2017): Trashëgimia kulturore dhe materiale në komunën e Gjakovës. Punim i temës së masterit. UPZ "Ukshin Hoti", Prizren.
12. Millaku, F., Rexhepi, F., Krasniqi, E., Pajazitaj, Q., Mala, Xh., Berisha, N. (2013): Libri i kuq i florës vaskulare të Republikës së Kosovës. MMPH. Prishtinë
13. MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë.
14. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Prishtinë.
15. MMPH-AKMM-IKMN (2015): Raport për gjendejen e natyrës 2010-2014. Design House. Prishtinë.
16. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design. Prishtinë.
17. Osmani, J. (2010): Vendbanimet e Kosovës 14. Gjakova. Shtypi Kompania "Karmine" Stamboll. Prishtinë.
18. Pjetraj, P. (2016): Flora vaskulare në serpentinet e Sukës (Hereq-Baballoq). Punim i masterit.UP-FSHMN. Prishtinë.
19. Pllana, R. (2015): Klima e Kosovës. ASHAK. Prishtinë.
20. Rexhepi, F. (1982): Vegjetacioni i Kosovës dikur dhe sot. Përparimi 2-3, Prishtinë.
21. Rexhepi, F. (1994): Vegjetacioni i Kosovës. UP-FSHN. Prishtinë.
22. Rexhepi, F. (2007): The vegetation of Kosovo. UP-FNS. Prishtinë.